



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.372/06

GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË, si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Lekë Prenaj në çështjen juridike të paditëses N.P.B. rr. "B.K. " p.n. P., të cilën e përfaqëson F.I. jur.e dip.me autorizim, kundër të paditurit Sh.B. nga P. lagja D. " K. i B. " Llam..., Hyrja.... ban.nr...., për pagesën e borxhit, në shqyrtimit kryesor-publik në prezencën e përfaqësueses së paditëses dhe në mungesë të të paditurit , të mbajtur me datën, 18.03.2011, muar dhe komunikoj këtë:

A K T G J Y K I M

MIRATOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses N.P.B.me seli në P., **DETYROHET** i padituri Sh.B. nga P., që paditëses t'ia paguaj në emër të borxhit për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokalit afarist në lagjen D. "K. i B. " Lam. numri i lokalit ..., shumën e mbetur prej 2,219.23 €, me kamatë 3.5 % në vit, nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 40 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënimit të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja në padi dhe përmes përfaqësueses së saj të autorizuar, në seancën e dt. 18.03.2011, ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditëses në emër të borxhit të pa paguar për blerjen e lokalit afarist (përmes bashkimit të mjeteve), në lagja D. "K. i B." Llam..., lokali nr.... me sipërfaqe prej 33,80 m², t'ia paguaj shumën prej 2.219,23 € me kamatë ligjore prej 3.5 nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Ka shtuar se paditësja me të paditurin kanë lidhur kontratë për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokalit të objektit banesorë në lagjen D. "K. i B.", sipas kontratës nr. 05-2302/1 të dt. 21.09.2001, e cila gjendet në shkresat e lëndës . Ka theksuar se paditësja e ka informuar të paditurin me vërejtje që në afat prej 7 ditësh të përmbush detyrimin e mbetur në shumën prej 2,219.23 €, por i padituri edhe për kundër vërejtjes me shkrim borxhin e tij nuk e ka përmbushur .

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në emër të taksës gjyqësore për padi dhe aktgjykim.

I padituri ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e shqyrtimit kryesor të caktuar me dt. 18.03.2011 në ora 9:30, por ka munguar duke mos e arsyetuar në kurrfarë forme mungesën e tij, prandaj Gjykata me propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses e në bazë të nenit 423.4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti pa praninë e të paditurit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave në seancën kryesore të shqyrtimit publik të dt.18.03.2011, bëri administrimin e provave relevante materiale me leximin e : Kontratës mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokaleve afariste nr. 05-2302/1 të dt. 21.09.2001; Kartelës së kontos së të paditurit nr.... për periudhën 01.01.2006-20.02.2006; Vërejtjes nr. ... e dt. ... të paditëses derguar të paditurit..

Gjykata pasi vlerësoj provat e administruar e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga kontrata e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokalit afarist vërtetohet se palët kanë krijuar marrëdhënjen juridike detyrimore (kontratën) ku janë dakorduar për kushtet esenciale të kontratës.

Kjo kontratë në kuptim të nenit 148 të LMD-së ka krijuar efekte juridike për palët kontraktuese (palët ndërgjyqëse) duke krijuar të drejta për kreditorin dhe detyrimin për debitorin .

Në mes të palëve nuk është kontestuese ekzistimi i marrëdhënjes juridike, por kontestuese është mospërbushja e borxhit kontraktues në shumën prej 2,219.23 €, nga ana e të paditurit.

Nga kartela e kontos së të paditurit të ofruar nga paditësja si provë, vërtetohet se i padituri ka ngelur pa e përmbushur kontratën edhe për shumën prej 2.219,23 €.

Nga vërejtja numër ... e dt. ..., vërtetohet se paditësi i ka bërë vërejtje të shkruar të paditurit për përmbushjen e detyrimit financiar komform me dinamiken , përkatësisht afatet e përcaktuar me kontratën për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokalit afarist, ku i është lënë afati prej 7 ditësh për ta përmbushur detyrimin në shumën prej 2.219,23 €.

Si rezultat i gjithë kësaj gjykata vlerëson se i padituri është debitor në këtë marrëdhënie juridike, kurse paditësi është kreditor.

Sipas nenit 262 para.1 i LMD-së , kreditori në marrëdhënjen detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit, kurse debitori është i detyruar që ta përmbushë detyrimin e tij me ndërgjegje dhe në tërësi sikurse është përmbajtja e tij (përmbajtja e detyrimit).

Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se i padituri ka ngel borxh ndaj paditëses i cili borxh konsiston në mos pagesën e shumës së mbetur prej 2.219,23 €, për bashkim e mjeteve për ndërtimin e lokalit afarist, prandaj gjykata me zbatimin e dispozitës së lartcekur, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurin që paditëses t'ia paguaj borxhin e papaguar në shumë prej 2.219,32 €.

Gjykata vendimin për lartësinë e kamatës e ka mbështetur në nenit 277 pika 1 të LMD-së.

Vendimi për shpenzimin e procedurës është i bazuar në dispozitat e neneve 449.1 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilëve paditësit i pranohen shpenzimet për taksë gjyqësore për padi 20 € dhe për aktgjykim 20 €, gjithsejtë 40 €.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË
C.nr.372/06, 18.03.2011.

Gj y q t a r i ,
Lekë Prenaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,
Gjykatës së Qarkut në Prishtinë e nëpërmes të kësaj gjykate.

